



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahim	28.07.2026	07.08.2026	2026/0529

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24.07.2026, OE “KRASNIQI SERVICE SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0529, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Gentian Sakaj B.I.”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirembajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare te SHCK-se ne Komunen e Pejës” me nr. të prokurimit: "635-26-318-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00 €.

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2026/0336 i dt: 22.06.2026. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ky është Vendimi (14.07.2026) i katërt i marrë nga Autoriteti Kontraktues (AK) në kuadër të kësaj procedure të prokurimit dhe refuzimi i kërkesës për rishqyrtim.

1. Vendimi fillestar i Autoritetit Kontraktues

1.1. Autoriteti Kontraktues fillimisht e kishte rekomanduar për dhënie të kontratës

Operatorin Ekonomik (OE) SEFERI MONT.

1.2. Ne kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesin e Pasuksesshëm.

1.3. Operatori Ekonomik Gentian Sakaj B.I. ishte eliminuar për shkak të mosplotësimit të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe Formularit të Tenderit (FDT).

2. Anulimi i procedurës së prokurimit

Pas qasjes në dokumentacionin e tenderit, kemi konstatuar se OE i rekomanduar kishte gabime aritmetike dhe kishte ndërhyrë në paramasë. Autoriteti Kontraktues, me vendimin e datës 26.03.2026, ka anuluar procedurën e prokurimit.

Ne kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim ndaj këtij vendimi, mirëpo kërkesa jonë është refuzuar nga AK.

3. Ankesa në OSHP dhe vendimi për rivlerësim

Pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, kemi ushtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Me vendimin nr. 216/26, OSHP ka aprovuar ankesën tonë dhe ka detyruar Autoritetin Kontraktues që lëndën ta kthejë në rivlerësim, duke konstatuar se anulimi i procedurës ishte bërë në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Rrjedhimisht, sipas Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0216, të datës 04.05.2026, AK është obliguar të kryejë rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë.

3.1. OE SEFERI MONT nuk ka ushtruar ankesë as ndaj vendimit të AK-së dhe as në OSHP.

3.2. OE Gentian Sakaj B.I. gjithashtu nuk ka ushtruar ankesë as ndaj vendimit të AK-së dhe as në OSHP.

4. Vendimi i AK-së gjatë rivlerësimit

Gjatë procesit të rivlerësimit, me vendimin e datës 13.05.2026, Autoriteti Kontraktues ka eliminuar të gjithë operatorët ekonomikë, përfshirë edhe ofertën tonë, duke pretenduar se nuk përmbushnim një kërkesë të FDT-së, e cila në fakt nuk ka ekzistuar fare në dokumentacionin e tenderit.

4.1. Ndërkohë, ofertat e OE SEFERI MONT dhe Gentian Sakaj B.I. (i rekomanduari me vendimin e fundit) janë eliminuar duke u dhënë arsyetimet përkatëse nga AK.

4.2. Asnjëri prej këtyre operatorëve ekonomikë nuk ka ushtruar ankesë ndaj vendimit të AK-së të datës 13.05.2026, as pranë AK-së dhe as në OSHP.

Ne kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim ndaj këtij vendimi, por edhe kjo kërkesë është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues.

Më pas kemi paraqitur ankesë në OSHP si pala e vetme me interes juridik dhe si operator ekonomik i përgjegjshëm.

Me vendimin e datës 22.06.2026, nr. OSHP 2026/0336, OSHP ka aprovuar ankesën tonë dhe ka detyruar Autoritetin Kontraktues që lëndën ta kthejë përsëri në rivlerësim, duke urdhëruar njëkohësisht:

4. Urdhërohet Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës që, brenda afatit prej pesë (5) ditësh kalendarike, ta njoftojë OSHP-në lidhur me zbatimin e Vendimit të OSHP-së nr. PSh.2026/0216, të datës 04.05.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës", me numër të prokurimit 635-26-318-2-1-1.

5. Mosrespektimi i kësaj urdhërese brenda afatit prej pesë (5) ditësh kalendarike do ta detyrojë Panelin Shqyrtues të veprojë në përputhje me nenin 131 të LPP-së dhe, njëkohësisht, të kërkojë nga KRPP anulimin e licencës së menaxherit të prokurimit të AK së – Komuna e Pejës, në përputhje me nenin 25, paragrafët 8 dhe 9 të LPP-së.

Megjithatë, më datë 14.07.2026, në kundërshtim me Vendimin e OSHP-së të datës 22.06.2026, në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe me nenin 40 të Rregullores për Prokurimin Publik nr. 001/2022, Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie të

kontratës një operator ekonomik, të cilin në të gjitha vendimet paraprake vetë e kishte vlerësuar si operator të përgjegjshëm dhe jo të përgjegjshëm.

Ky operator ekonomik, për më tepër, është pajtuar vazhdimisht me vlerësimet dhe konstatimet e Autoritetit Kontraktues, duke mos ushtruar asnjë mjet juridik kundër tyre.

Në vijim paraqesim vetëm disa nga arsyet të cilat vetë Autoriteti Kontraktues i kishte evidentuar në vendimet paraprake për eliminimin e këtij operatori ekonomik:

Njoftim për Refuzim të Ofertës – OE: " Gentian Sakaj B.L.

Gjatë rivlerësimit të ofertës suaj, Komisioni Vlerësues ka konstatuar se oferta nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, në përputhje me:

- Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, përkatësisht Neni 56 (Refuzimi i Tenderëve) dhe Neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve);
- Rregulloren Nr. 002/2024 (A002 – Versioni i Konsoliduar), për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, përkatësisht dispozitat që rregullojnë kriteret e përzgjedhjes dhe dëshmitë për përmbushjen e tyre.

Në vijim paraqiten arsyet e eliminimit:

ELIMINIMI 1 – Mosplotësimi i kërkesave për objektin e punës

Sipas Dosjes së Tenderit, është kërkuar që Operatori Ekonomik (OE) të posedojë hapësirë të mjaftueshme pune, me këto karakteristika minimale:

- sipërfaqe minimale 100 m²,
- hapësirë e mbyllur dhe e mbrojtur,
- distancë maksimale deri në 20 km nga Autoriteti Kontraktues.

Në rast se objekti tejkalon këtë distancë, OE obligohet të sigurojë bartjen e automjeteve pa kosto për Autoritetin Kontraktues, për çka kërkohej dorëzimi i deklaratës përkatëse dëshmuuese.

Konstatim:

Ju nuk keni dorëzuar deklaratën dëshmuuese për përmbushjen e këtij obligimi në rast të tejkalimit të distancës mbi 20 km. Rrjedhimisht, nuk përmbushni këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit.

ELIMINIMI 2 – Mosplotësimi i përvojës në projekte të ngjashme

Sipas Dosjes së Tenderit dhe në përputhje me Nenin 65 të LPP-së (Kriteret e Përzgjedhjes), është kërkuar që:

- OE të dëshmojë realizimin me sukses të kontratave të ngjashme (servisim i automjeteve) në vlerë minimale prej 130,000.00 € gjatë tre (3) viteve të fundit;
- kontratat duhet të jenë të përfunduara dhe të dëshmuara me referenca përkatëse.

Konstatim:

Ju keni dorëzuar Aneksin 6 me listën e kontratave në vlerë totale prej 142,863.52 €, mirëpo:

- Kontrata në vlerë prej 4,780.00 € me Policinë e Kosovës nuk konsiderohet kontratë e ngjashme, pasi ka të bëjë me furnizim me pajisje diagnostike dhe jo me servisim të automjeteve;
- Kontrata me Komunën e Dragashit në vlerë prej 60,000.00 € është ende aktive (21.03.2024 – 20.03.2026) dhe nuk është dëshmuar si e përfunduar me sukses;
- Nuk është ofruar asnjë dëshmi se kjo kontratë është përfunduar para afatit të paraparë, apo dokument që vërteton realizimin e saj të plotë.

Rrjedhimisht, OE nuk arrin të dëshmojë përmbushjen e kërkesës për përvojë në projekte të ngjashme sipas vlerës së kërkuar.

ELIMINIMI 3 – Kontratë pune e pavlefshme

Është dorëzuar kontratë pune ndërmjet:

- GENTIAN SAKAJ B.I dhe
- GENTIAN SAKAJ, si pronar i subjektit ekonomik.

Konstatim:

Kjo kontratë nuk konsiderohet kontratë valide pune, pasi është lidhur ndërmjet të njëjtit subjekt fizik/juridik dhe nuk përbën dëshmi të vlefshme të marrëdhënies së punës, në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

ELIMINIMI 4 – Mosvulosja e Aneksit 1 të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme

Komisioni Rivlerësues ka konstatuar se Operatori Ekonomik nuk ka vulosur Aneksin 1 të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme, i cili përbën kusht thelbësor dhe duhet të plotësohet dhe dorëzohet së bashku me deklaratën e ofertës.

Mosvulosja e këtij aneksi, në të cilin janë të regjistruara automjetet (vetura, automjete dhe kamionë), nënkupton mospërputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt

Milot Gashi Menaxher i Prokurimit

Pra AK vetëm e vetëm për të mos na rekomanduar neve për kontratë, në kundërshtim me LPP-në dhe në kundërshtim të plotë me Vendimet e OSHP-së, ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është plotësisht i pa përgjegjshëm e njëkohësisht tashme është palë pa interes sepse i njëjti është pajtuar me eliminimin e ofertës së tij në të gjitha vendimet e AK dhe Vendimet e OSHP-së të cekura më sipër.

Kërkojmë nga OSHP që të aprovojë ANKESËN tonë si të bazuar, të detyrojë AK që lëndën ta kthejë në rivlerësim dhe pas rivlerësimit në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe dokumentacionin e tenderit, të na rekomandojë për dhënie të kontratës si Operator Ekonomik i përgjegjshëm dhe i përgjegjshëm ekonomikisht.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për Projektet të ngjajshme (servisim i automjeteve) në vler prej 130.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 50% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3 vitet e fundit. Kërkesa 2 OE duhet të ketë së paku tre punonjës të kualifikuar – mekanik ,autollamarist dhe elektrikist te cilët punojnë për OE në fushat që lidhen me këtë kontratë Kërkesa 2.1 OE duhet të ketë një(1) inxhinier i diplomuar i maqinerisë Kërkesa 3 OE duhet te ketë se paku pajisjet e poshtëshënuara Vinça hidraulik për ngritjen e automjeteve - minimum tri (3) vinça; Kërkesa 4 OE duhet te ketë hapësire te mjaftueshme te objektit për pune. Sipërfaqja e hapësirës se objektit për pune duhet te jete minimum 100 m2. Kjo hapësire duhet te jete e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve te jashtme siç janë reshjet, era, pluhuri etj. Largësia mksimale e objektit për servisim të mos jetë mbi 20 km.Nëse objekti kalon këtë largësi atëherë kompania fituese e tenderit bartjen e automjeteve do ta bënë vet kompania pa obligime nga Autoriteti Kontraktues Kërkesa 5 Specifikimi teknik i detyrueshëm	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referenca ose procesverbalet për kryerje të punëve. Projek e realizuara ne sektorin privat duhet te deshmohe me pagesa ne bank Dëshmia 2 Ofertuesit duhet të paraqesin CV-it secilit prej punonjësve të kualifikuar dhe diploma apo certifikata. Dëshmia 2.1 Ofertuesit duhet të paraqesin CV- e inxhinierit,si dhe diplomen Dëshmia 3 OE duhet të dorëzoj një listë të pajisjeve.te vertetuar nga OE Dëshmia 4 Një deklaratë e nënshkruar nga OE deklaron m2 të sipërfaqes së punës , fotografi dhe dokumentacion tjetër dëshmues Dëshmia 5 Deklarat e O.E (e nënshkrua dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve tekn të detyrueshme të dhëna nga A.K
---	---

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "KRASNIQI SERVICE SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës" me numër të prokurimit: "635-26-318-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT
KOMUNA E PEJËS

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: : Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës RIVLERSIM

Nr. i prokurimit ¹	635-26-318-2-1-1
Nr i brendshëm	635/26/001/211

Radhë	Lënda / grupi: Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës	Çmimi i Pergjithshëm i peshuar (me TVSH)
1.	Gentian Sakaj B.I	35,792.60
2.	"SEFERI- MONT" SH.P.K., 601248116	53,885.08
3.	KRASNIQI SERVICE SH.P.K., 812299031	55,677.20

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

KOMUNA E PEJES shpërblen me kontratë Gentian Sakaj B.I," Me Çmimi total të peshuar të ofertes 35,792.60Euro

Data: 14.07.2026

Menaxheri i Prokurimit
Milot Gashi

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

2026/336

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - KRASNIQI SERVICE SH.P.K.

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar për herë të tretë ankesë pranë OSHP-së në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, duke ngritur pretendime ankimore të cilat janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues dhe i njëjti sipas mendimit të tij ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1

“Ky aktivitet përmbanë katër vendime të marra nga AK, së pari është rekomanduar për kontratë OE Seferi Mont, ndërsa Gentian Sakaj B.I. është eliminuar për arsye të mos plotësimit të kërkesave të dosjes, pasi që kemi paraqitur ndërhyrjet në paramasë nga ana e OE të rekomanduar, AK ka anuluar këtë procedurë. Me ankesën e bërë në OSHP, lënda është kthyer në rivlerësim ku AK ka eliminuar të gjithë operatorët ekonomik, edhe ne me arsyen e kërkesave të cilat nuk kanë ekzistuar fare në dokumentet e tenderit. Asnjëri nga operatorët pjesëmarrës nuk kanë ushtruar të drejtën e ankimit në lidhje me vendimet e marra nga AK. Ne pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, përsëri kemi bërë ankesë në OSHP ku është aprovuar kërkesa jonë nga OSHP dhe lënda është kthyer në rivlerësim dhe pas rivlerësimit është rekomanduar për kontratë një operator i cili vazhdimisht është pajtuar me vlerësimet dhe konstatimet e autoritetit kontraktues duke mos ushtruar asnjë mjet juridik për kundërshtimin e tyre.”

Përgjigje

Eksperti shqyrtues sqaron që kjo është ankesa e tretë e cila pranohet në Organin Shqyrtues të Prokurimit, e parashtruar nga i njëjti operator ekonomik. Me vendimin e fundit të lëshuar nga Paneli Shqyrtues lënda është kthyer në rivlerësim për herën e dytë dhe pas rivlerësimit, AK ka rekomanduar për kontratë një operator tjetër ekonomik i cili ka çmimin më të ulët por që me vendimet e lëshuara më parë nga AK i njëjti është eliminuar për arsye të caktuara dhe vetëm me vendimin e fundit ky operator është rekomanduar për kontratë.

Sqarojmë që sipas evidencës në sistemin e-prokurimi, OE i rekomanduar për kontratë shihet se vetëm njëherë ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim në kuadër të Autoritet Kontraktues me datë 21/03/2026 dhe pas kësaj kërkesë ky operator nuk ka atakuar më asnjë vendim tjetër të publikuar nga ana e AK-së as me kërkesë për rishqyrtim dhe as me ankesë në OSHP. Në rastin konkret eksperti sipas mendimit të tij sqaron që arsyet për të cilat është eliminuar OE i rekomanduar më herët janë atakuar vetëm pranë Autoritetit Kontraktues mirëpo sipas përgjigjes së AK-së lënda është kthyer në rivlerësim sa i përket gabimeve në paramasën e evidentuar dhe jo për shkak të pretendimeve të tjera të pranuar nga OE ankues, ku pas kësaj AK ka nxjerrur vendim për anulimin e tenderit. Pra, vetëm pas atakimit të vendimit për anulim dhe pas kthimit të lëndës në rivlerësim me vendimin e OSHP-së, AK nga operator i eliminuar ka nxjerrur vendim për rekomandim si i përgjegjshëm për të njëjtin operator, arsyet e eliminimit të të cilit nuk janë shqyrtuar asnjëherë dhe për to nuk është dhënë përgjigje as në kuadër të autoritetit kontraktues dhe as nga OSHP. Megjithatë, sqarojmë që duke marrë parasysh që OSHP ka pranuar edhe një ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit, ku janë ngritur edhe pretendime për OE i rekomanduar dhe pas shqyrtimit të tyre sipas mendimit të ekspertit në raportin tjetër kemi sqaruar që OE i rekomanduar nuk i ka përmbushur tërësisht kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket kontratave të ngjashme në tre vitet e fundit përkatësisht dokumentit të dorëzuar si referencë për kontratën e fundit nga lista e kontratave, megjithatë mbetet në diskrecionin e Autoritetit Kontraktues verifikimi i tyre sipas nenit 52.7 të LPP-së.

Sipas mendimit tonë vlerësojmë që rasti se kur duhet të merren parasysh të gjithë operatorët ekonomik me pranimin e një ankesë dhe kthimit të lëndës në rivlerësim është rasti kur të gjithë operatorët ekonomik eliminohen për një arsye të njëjtë e cila më pas nga OSHP sqarohet se nuk konsiderohet arsye e eliminimit dhe në rastin e tillë konform nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) të gjithë operatorët për arsye të njëjta të eliminimit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa marrë parasysh parashtrimin të ankesave apo jo nga ana e atyre operatorëve. Nga sqarimet e bëra më lartë vlerësojmë që pretendimi i ngritur nga ana e OE ankues është pjesërisht i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “KRASNIQI SERVICE SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-318-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **KRASNIQI SERVICE SH.P.K.**

Agnese Ibrahim

